



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 40/2019 (JR)  
Nr. 40/4 regj.

Tiranë, më 16.10.2020

**SHPALLJE**

**E**

**NJOFTIMIT PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se sot, më datë 16.10.2020, ora 10:00, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen me numër regjistri (JR) 40/2019, datë 04.09.2019 për ankimin e subjektit të rivlerësimit Arjana Fullani kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 186, datë 23.07.2019, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve, ditën e mërkurë, në datën 04.11.2020, ora 10.30.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykoës përbëhet nga gjyqtarët:

**Kryesuese e Trupit Gjykoës**  
**Relatore e Çështjes**  
**Gjyqtare**  
**Gjyqtare**  
**Gjyqtar**

**Albana Shtylla**  
**Natasha Mulaj**  
**Ina Rama**  
**Rezarta Schuetz**  
**Sokol Çomo**

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 51, pika 2 të ligjit “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë para seancës gjyqësore, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe atë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike të subjektit të rivlerësimit.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES**  
**GJYQTARE**

**ALBANA SHTYLLA**

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë, [www.kpa.al](http://www.kpa.al), e-mail: [info@kpa.al](mailto:info@kpa.al)

